



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**Në ankesën e**

**AC-II-23-0009**

**Paditësja**

**Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve"** në Pejë, të cilën e përfaqëson sipas Autorizimit **Sh D.**

**Kundër**

**E paditura/Ankuesja**

**Komuna e Klinës** me seli në Klinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, I.E.K nr.289/20 të datës 12 maj 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 24 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. DHPGJS-ja nuk ka juridiksion ta gjykoj ankesën e të paditurës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, I.E.K.nr.289/20 të datës 12 maj 2021.**
- 2. Dosja e lëndës me ankesë kthehet prapa në kompetencë të Gjykatës Komerciale në Prishtinë.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datë 24 shtator 2008, paditësi e dorëzon në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë një padi për kompensim të dëmit, duke kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura ti paguaj paditësit në emër të kompensimit të dëmit shumë prej 348.890,90 euro me kamatë prej 3.5% prej ditës së parashtrimit të

padisë e deri në pagesën e plotë. Për më tepër në padi paditësi ka pohuar se e paditura me datë 21 shtator 2007 në mënyrë arbitrare e ka rrënuar stacionin e autobusëve, njësinë në Klinë e cila ishte në pronësi të NSH "Kosova trans" në Pejë, dhe i cili objekt është ndërtuar me investimet nga vetë kjo NSH si investitorë, dhe e ndërtuar nga punë kryesi Ndërmarrjes ndërtimore "I" nga Peja. Kjo padi regjistrohet me numrin I.C.367/08.

Me datë 13 tetor 2008, e paditura e dorëzon në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë përgjigjen në padi. Në përgjigje në padi e paditura i kundërshton pretendimet e padisë duke i konsideruara si të pa bazuara në ligj. E paditura pohon se paditësi nuk posedon dokumentacion valid paraprak dhe të domosdoshëm për dhënien në shfrytëzim eventuale të ngastrës nr...., ZK D, lidhur me ndërtimin e Stacionit të Autobusëve. E paditura pohon se mungesa e vendimit për të drejtën e shfrytëzimit të ngastrës së cekur e bënë të jetë pa bazë juridike dhe të pa qëndrueshëm, Aktvendimin për lejimin e lokacionit nr.04-353-1029 të datës 27 gusht 1987, si dhe Lejen e ndërtimit nr.04-351-1029/2-87. Andaj e paditura pohon se janë pa bazë juridike provat të cilat i ka sjellë paditësja me padi. E paditura pohon se vendimet e cekura janë lëshuar pa bazë juridike, dhe është lejuar ndërtimi në tokën e huaj, në këtë rast në tokën komunale. Tutje e paditura pohon se paditësja nuk mund të kërkon kompensim për objektin e ndërtuar në tokën e huaj. E paditura ka kërkuar që të pezullohet procedura e filluar sipas padisë, në kuptim të nenit 67 pika 68.1 të LMFP, ose të refuzohet padia si e pa bazuar.

Me datë 12 maj 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin I.C.nr.367/2008, e aprovon kërkesë padinë e paditësit si të bazuar, dhe e detyron të paditurën që në emër të kompensimit të dëmit ti paguaj paditësit shumën prej 348.890,90 euro, me kamatë ligjore prej 3,5%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë, si dhe e ka obliguar të paditurën të paguaj shpenzimet gjyqësore prej 1000 euro.

Me datë 29 qershor 2010, e paditura e dorëzon një ankesë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të kësaj gjykate, I.C. nr. 367/2008 të datës 12 maj 2009, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të

kthehet në rigjykim. Kjo ankesë është proceduar për vendosje në Gjykatën e Apelit të Kosovës ,dhe aty regjistrohet me numrin Ac.nr.96/2012.

Me datë 22 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë me Aktvendimin Ac.nr.96/2012 e aprovon ankesën e të paditurës si të bazuar, e prish Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, dhe lënden e kthehen në rigjykim në Gjykatën e Shkallës së I-rë.

Lënda e kthyer në rigjykim, tash dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, dhe aty regjistrohet me numrin I.E.K.nr.289/20.

Me datë 22 shtator 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë e mban një seancë dëgjimore mbi padinë. Në bazë të procesverbalit të kësaj seance shihet se përfaqësuesi i paditësit ka kërkuar nga Gjykata që lënda të udhëhiqet me emërtimin e ri të palës paditëse, si NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Pejë, nga shkak se nga viti 2015, kjo ndërmarrje e bartë këtë emër dhe është e Komunës së Pejës. Në bazë të procesverbalit të seancës vërehet se Gjykata Themelore në Prishtinë ka marrë Aktvendim dhe e ka aprovuar kërkesën për ndryshim të padisë përkitazi me emërtimin e palës paditëse, ashtu që si palë paditëse është emëruar NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. me seli në Pejë.

Pas disa zhvillimeve të tjera procedurale, me datë 12 maj 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike me Aktgjykimin I.E.K.nr.289/20, e aprovon pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyron të paditurën që në emër të kompensimit të dëmit për rrënimin e objektit të Stacionit të Autobusëve në Klinë, t'i paguaj paditësit shumen prej 87,000.00 euro si dhe kamatën në lartësinë e deponimit të mjeteve monetare në bankat komerciale për periudhën e deponimit prej mbi një vit dhe pa definim të caktuar, nga data e paraqitjes së padisë 23.09.2008 e deri në pagesën e plote të borxhit. Me piken e dytë të dispozitivit të Aktgjykimit, refuzohet pjesa tjerë e kërkesëpadisë përtej shumes së aprovuar e deri në shumen e kërkuar prej 348.890.90 euro, si dhe e detyron të paditurën të paguaj paditësit shumen e shpenzimeve të procedurës kontestimore prej 430.00 euro. Gjykata Themelore në Prishtinë ka arsyetuar se në rastin konkret me provat e administruara është

vërtetuar se është asgjësuar pasuria e palës paditëse, duke u rrënuar objekti ndërtimor i Stacionit të Autobusëve i cili ishte ndërtuar nga paditësi në vitin 2007. Andaj duke u bazuar në nenin 154 të LMD-së të vitit 1977, dhe në dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, është detyruar e paditura të ia kompensoj paditësit dëmin e shkaktuar me rrënimin e objektit pa pëlqimin e tij, në vlerën financiare prej 87,000.00 euro.

Me datë 28 maj 2021, e paditura e dorëzon në Gjykatën Themelore në Prishtinë një ankesë kundër Aktgjyimit të kësaj Gjykate I.E.K.nr.289/20 të datës 12 maj 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë që të prishet Aktgjykimi i ankimuar, dhe lënda të kthehet në rigjykim në Shkallën e I-rë. E paditura në ankesë i kundërshton konstatimet e dhëna në Aktgjykimin e ankimuar duke i konsideruar si të pa bazuara në Ligj. E paditura pohon se Gjykata në rishqyrtim u ka ikur vlerësimeve dhe argumenteve të dhëna nga Gjykata e Apelit kur më herët e kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. Tutje e paditura pohon se mbështetja e Aktgjyimit në një ekspertizë, është e pa qëndrueshme dhe e pa pranueshme për shume arsyeje të cilat janë paraqitur dhe argumentuar, duke filluar nga pa vlefshmëria e objektit lëndor e deri tek caktimi i ekspertizës kontestuese. Tutje e paditura pretendon se objekti lëndor ishte shkatërruar nga një subjekt tjerë, siç ishte NATO si force sigurie në Kosovë, e ky shkatërrim nuk mund të i mëveshët Komunës së Klinës. E paditura pohon se paditësja nuk e ka paditur subjektin realisht që e ka rrënuar objektin lëndor, por në këtë rast e ka paditur Komunën që nuk është përgjegjëse për rrënim të këtij objekti. Tutje e paditura konsideron se administrimi i provave nuk nënkupton vlerësim të provave e që në këtë rast ky vlerësim mungon. Certifikata e pronësisë e datës 06 shkurt 2009, është anashkaluar fare me arsyeje se kjo është lëshuar nga Komuna, e që kjo ishte kompetence e saj. Tutje në ankesë ajo pretendon se rrënimin nuk e ka bërë e paditura, ndërsa heqja e mbeturinave të objektit të shkatërruar dhe lirim të pronës tokësore komunale, ku ka qenë i ndërtuar objekti, nuk mund të konsiderohet rrënim i objektit siç konstaton Gjykata. E paditura konsideron se në Aktgjykimin e ankimuar janë shkelur dispozitat e nenit 182 pika e lidhur me nenin 8 pika 8.2 të LPK-së. E paditura pohon se gjykata nuk ia ka falur besimin provës kryesore dhe relevante, certifikatës së Drejtorisë së Urbanizimit të datës 06.02.2009. Tutje e paditura me ankesë e konteston

edhe kompetencën lëndore të Gjykatës për të vendosur në këtë lëndë, duke pohuar se Komunitat nuk e kanë statusin e shoqërive tregtare.

Kjo ankesë pas themelimit të Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është proceduar në këtë Gjykatë, dhe ajo aty e merr numrin K.DH.SHK.II.nr.826/22.

Në bazë të fletëdorëzimit që ekziston në dosje, ankesa e të paditurës i është dërguar paditësit me datë 02 qershor 2021, mirëpo në dosje nuk ka prova se ka dhënë përgjigje në këtë ankesë.

Me datë 06 mars 2023, Gjykata Komerciale e Kosovës në Prishtinë, me Aktin përcjellës K.DH.SHK.II.nr.826/22, dosjen e lëndës së bashku me këtë ankesë e përcjellë në DHPGJS, duke e konsideruar se DHPGJS-ja në bazë të nenit 5 par. 4.5 të LDHP-së, ka jurisdikcion lëndore ta gjykojë ankesën.

Me datë 15 mars 2023, Zyra e Regjistrimit e DHPGJS-së, këtë dosje e regjistron për Kolegjin e Apelit, dhe ajo merr numrin AC-II-23-0009.

### **Arsyetimi ligjor**

DHPGJS-ja nuk ka jurisdikcion ta gjykojë ankesën.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Mungesa e jurisdikcionit të DHPGJS-së për shqyrtimin e ankesës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë**

Jurisdikcioni i DHPGJS është i rregulluar me Nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: LDHP), kurse Neni 6 i LDHP-së përcakton se kush mund të jetë Paditës dhe i Paditur në procedurën para DHPGJS-së.

Neni 5, paragrafi 1.4, i LDHP thotë se DHPGJS ka kompetencë ekskluzive mbi një padi kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që supozohet të ketë lindur gjatë ose para kohës kur Ndërmarrja apo Korporata e tillë është apo ishte subjekt i autoritetit administrativ i AKM-së, Agjencia.

Sipas Nenit 2 të LDHP, termi "Ndërmarrje" i përdorur në këtë ligj ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 3 të Ligjit No.03/L-067, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej: Ligji për AKP).

Neni 3 i Ligjit për AKP-së thotë se termi " Ndërmarrje" nënkupton një ndërmarrje mbi të cilën Agjencia ka kompetenca sipas Nenit 5.1 (a) (i) të Ligjit të njëjtë.

Sipas Nenit 5.1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për AKP-së, *"Agjencia ka autoritetin të administrojë ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar Transformimit"*.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111, në nenin 23, i ka listuar ndërmarrjet publike qendrore, ato rajonale dhe ato lokale. Në bazë të këtij neni të këtij Ligji, është dhënë edhe lista nr.2 e ndërmarrjeve publike lokale. Sipas listës nr.2 të përcaktuar në këtë dispozitë ligjore, Stacioni autobusëve në Pejë, i cila në këtë lëndë është palë e paditëse, është listuar në numrin rendor 19.

Sipas nenit 3.2 të Ligjit bazë për Ndërmarrjet nr. 03/L-087, të gjitha Ndërmarrjet lokale publike janë në pronësi të Komunave të përcaktuara në listën nr. 2. Paditësi në rastin në fjalë është Ndërmarrje lokale publike, e radhitur në pikën 17, në Listën 2 të Ligjit për Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

E Paditura është një Autoritet Publik dhe jo një Ndërmarrje apo Korporatë, siç kërkohet në Nenin 5, paragrafi 1.4 i LDHP-së, e as një i Paditur i vetëm, siç kërkohet në Nenin 6, paragrafi 2 i LDHP, prandaj DHPGJS-ja nuk ka juridiksion në këtë rast.

Tutje sipas nenit 6 paragrafi 2 nënpika 2.6 të LDHP-së, personi fizik dhe juridik apo autoritetet publike, mund të jenë palë të paditura në procedura para DHPGJS-së, në rastet në "të cilët në çfarëdo mënyre kanë hyrë apo lidhen në raport juridik me ndonjë Ndërmarrje, Korporatë apo Agjencinë".

Në këtë rast Komuna e Klinës si palë e paditur dhe si autoritet publik, në bazë të padisë së ndryshuar nga vetë paditësi në seancën gjyqësore të datës 22 shtator 2020, paditësi emërtohet si NLP "Stacioni i Autobusëve" SH.A Pejë. Kjo kërkesë për ndryshim të emërtimit të paditësit në padi, në bazë të procesverbalit të seancës, është aprovuar edhe nga gjykata e shkallës së I-rë.

Prandaj në bazë të padisë së ndryshuar, mund të konstatohet se është në raport i pretenduar juridik në mes NLP "Stacionin e Autobusëve" në Pejë si palë paditëse dhe Komunës së Klinës si palë e paditur, dhe ky raport nuk ndërlidhet me ndonjë ndërmarrje, Korporatë apo AKP-në, siç kërkohet shprehimisht në këtë dispozitë.

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Ndërmarrjet publike: "Qeveria do të ketë kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore (...)"

Për më tepër, ajo është e rregulluar në Nenin 13.1 Ligjit për Ndërmarrjet publike se: Përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë ligj, të gjitha NP si dhe zyrtarët dhe drejtorët e tyre, pa asnjë përjashtim, i nënshtrohen ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore të cilat i rregullojnë shoqëritë tregtare në pronësi private. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, shprehimisht përcaktohet se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka kompetencën ekskluzive për të gjitha procedurat e paaftësisë pague (insolvencës), likuidimit ose riorganizimit të një Ndërmarrje publike.

Rasti i tanishëm, megjithatë, nuk bie nën rregullat e jashtëzakonshme të përcaktuara më lart, dhe për këtë arsye DHPGJS-ja nuk ka juridiksion mbi të.

Tutje Kolegji i Apelit vë në pah se sipas nenit 5.8 të LDHP-së në zbatim, DHPGJS-së i është dhënë autoriteti ekskluziv për të vendosur nëse një lëndë specifike bie brenda fushë veprimit të paragrafit 1 të nenit 5 të LDHP-së.

Në aktin përcjellës me të cilin dosja dërgohet në DHPGJS, Gjykata Komerciale e Kosovës i referohet nenit 5 par.4 të LDHP-së, e cila dispozite ka të bëjë me lendet e referuara nga DHPGJS-ja, në Gjykatat e rregullta. Ky rast nuk është i tillë, pasi që kjo padi nuk është referuar asnjëherë nga DHPGJS-ja në kompetencën e gjykatës së rregullt. Paditësi padinë e kishte dorëzuar drejtpërdrejtë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Prandaj duke u bazuar në këto dispozita ligjore të LDHP-së, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat e cituara më lartë të Ligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Ndërmarrjet, Kolegji i Apelit e ka marrë në konsideratë faktin se Stacioni i Autobusëve SHA në Pejë, është Ndërmarrje Publike Lokale në pronësi të Komunës së Pejës.

Andaj Kolegji i Apelit konsideron se dosja e lëndës me ankesën e të paditurës, gabimisht është përcjellë nga Gjykata Komerciale e Kosovës në juridiksion të DHPGJS-së.

Duke u bazuar në këto arsye, Kolegji i Apelit dosjen e lëndës prapë e kthen në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, e cila ka kompetencën ta gjykoj ankesën e të paditurës, që është paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Me sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksa gjyqësore**

Kolegji i Apelit nuk caktoi pagesën e taksës gjyqësore për të paditurën lidhur me ankesën e paraqitur, pasi që kjo ankesë bartët për gjykim të mëtejme në Gjykatën Komerciale të Kosovës në Prishtinë, e cila do të vendosë edhe për taksën gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_